

VENDIM
Nr. 653, datë 7.8.2013

PËR AUTORIZIMIN E SHOQËRISË “V.A.L.E. RECYCLING” SHPK, PËR IMPORTIN E MBETJEVE PËR QËLLIME RICIKLIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 22 të ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 49 të ligjit nr. 10 463, datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autorizimin e shoqërisë “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., për importin e mbetjeve për qëllime riciklimi, me kodet e mëposhtme tarifore:

- | | |
|----------------------|--|
| - GA 040 72 04 10 00 | Mbetje dhe kthime të gizës së derdhur; |
| - GA 050 72 04 21 | Mbetje dhe kthime të çelikeve të lidhura; |
| - GA 070 72.04 30 00 | Mbetje dhe kthime të gizës dhe çelikut të kallajisur; |
| - GA 120 74 04 00 | Mbetje dhe kthime të bakrit; |
| - GA 140 76 02.00 | Mbetje dhe kthime të aluminit; |
| - GA 160 79 02 00 00 | Mbetje dhe kthime zinku; |
| - GA 150 78 02 00 00 | Mbetje dhe kthime të plumbit; |
| - GE 010 7001 00 | Qelq i thyer dhe mbetje të tjera qelqi; |
| - GH 010 3915 | Mbetjet, prerjet dhe kthimet prej plastike:
etilenit, stirenit, vinil-kloridit; |
| - GI 010 4707 | Letër apo karton i rikuperueshëm (mbetje dhe kthime); |
| - GL 010 44 0131 00 | Tallash, mbetje dhe kthime të drurit, nëse janë apo jo të aglomeruara në kërcunj, briketa, sfera apo në forma të ngjashme: sfera prej druri; |
| - GJ 120 63090000 | Veshje të përdorura dhe artikuj të tjerë veshjeje, |

dhe kodet e listës së Bazelit: B1010, B1020, B3010, B3020, B3030, B3040, bazuar në aneksin 1, “Mbetjet e listës së gjelbër”, referuar vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listave të mbetjeve që lejohen të importohen për qëllime përdorimi, riciklimi dhe përpunimi”, të ndryshuar.

2. Sasia e mbetjeve që importohet, sipas kodeve të referuara në pikën 1 të këtij vendimi, është 2000 (dy mijë) tonë në vit.

3. Mbetjet importohen nga shteti i Italisë. Transporti bëhet në rrugë tokësore dhe detare, pasi të jetë plotësuar i gjithë dokumentacioni i nevojshëm ligjor për transportin ndërkombëtar të mbetjeve, si dhe kërkesat e kreut II të vendimit nr. 806, datë 4.12.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave dhe procedurave për importimin e mbetjeve për qëllime përdorimi, përpunimi dhe riciklimi”.

4. Për çdo transfertë ndërkufitare të mbetjeve, shoqëria “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., dorëzon të plotësuar në Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dokumentin e lëvizjes/transfertës ndërkufitare të mbetjeve, sipas formatit të dhënë në anekset III dhe IV, bashkëlidhur vendimit nr. 825, datë 13.10.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe monitorimi i tyre të kryhet nga strukturat përkatëse të doganave. Çdo transfertë mbetjesh duhet të jetë e pajisur me raport-analizë, të kryer për aspektin e radioaktivitetit.

5. Periudha e lejitimit të importit të mbetjeve nga shoqëria “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., është njëvjeçare, nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, në zbatim të kërkesave të mësipërme ligjore dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik, merr masat e

nevojshme për kontrollin e procesit të riciklimit të mbetjeve nga shoqëria “V.A.L.E. Recycling” sh.p.k., pas miratimit të këtij vendimi.

7. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave komunikon me shkrim me shtetet eksportuese dhe ato ku do të bëhet kalimi transit i mbetjeve, për autorizimet përkatëse në bazë të të cilave lejohet kalimi i kësaj sasive të mbetjeve, në përmbushje të kërkesave të Konventës së Bazelit “Për kontrollin e lëvizjeve ndërkufitare të mbetjeve të rrezikshme dhe asgjësimin e tyre”, konventë në të cilën Republika e Shqipërisë është palë.

8. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha